



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 02.05.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **Mirusha Company Shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Kodra e Sukës-Cërmjan", Nr. i prokurimit- 632-23-1715-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-014 -521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **Mirusha Company Shpk**, e dt.02.05.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Kodra e Sukës-Cërmjan", Nr. i prokurimit- 632-23-1715-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-014 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.04.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 24.04.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.02.05.2023, Operatori Ekonomik " **Mirusha Company Shpk**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Kodra e Sukës-Cërmjan", Nr. i prokurimit- 632-23-1715-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-014 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 05.05.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë lidhur me diplomën e ing.Nysret Kastrati, nuk qëndron , sepse Autoritetit kontraktues konsideron se elementet kryesore (si emri , mbiemri, viti i regjistrimit , data e diplomimit)janë mjaftueshëm të dallueshme.

Pretendimi juaj i dytë gjithashtu nuk qëndron, sepse marrëveshja është e lidhur për këtë projekt dhe kjo nënkupton që është e vlefshme deri në përfundimin e tij. Sa i përket asaj që në marrëveshje nuk është përmendur se cilët kamion janë huazuar, sqarojmë se një gjë e tillë nuk është kërkuar në dosjen e tenderit.

Për sa ju përket cilindrave sqarojmë se për pajisjet e marruara me qira që nuk regjistrohen, sipas FDT mund të prezantohen edhe faturat e blerjes.

Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës